



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT  
MINISTRI

Nr. 4520 Prot.

Tiranë, më 30.12. 2015

URDHËR


Nr. 782, datë 30.12., 2015

PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PARKUT KOMBËTAR TË  
EKOSISTEMIT NATYROR DIVJAKË-KARAVASTA

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 15 e 16 pika c, të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Per zonat e mbrojtura”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjake-Karavasta të përgatitur në kuadër të Projektit “Per konservimin dhe përdorimin e qendrushëm të Parkut Kombëtar Divjake-Karavasta, me pjesëmarrjen e qeverisjes vendore dhe palëve të interesuara”, financuar nga Qeveria Japoneze nëpërmjet Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), sipas tekstit bashkelidhur.
2. Për zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjake-Karavasta ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me strukturat perkatese të pushtetit vendor, ministrive të linjës si dhe palët e tjera të interesuara.
3. Për të mbikqyrur zbatimin e planit të menaxhimit ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut.
4. Bazuar në dispozitat e ligjit 8906, datë 06.06.2002 “Per zonat e mbrojtura” të ndryshuar, plani i menaxhimit të “Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjake-Karavasta” të përfshihet e të integrohet në politikën, planet, programet dhe veprimtaritë që lidhen me to si dhe në vendimmarrjet e nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor.



5. Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të përcjelle Planin e Menaxhimit në institucionet, zbatimin e të cilit lidhet me fushat e përgjegjësisë shtetërore të tyre.
6. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjake-Karavasta të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mjedisit.
7. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjake-Karavasta, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mjedisit dhe Jetesimit të Prioriteteve, Drejtoria e Integritimit dhe Koordinimit të Projekteve, Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI

Lefter KOKA